



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:189377

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05811571

C.nr.556/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A.B, A.C-B dhe i mituri R.B, të cilin e përfaqëson, përfaqësuesja ligjore, e ëma A.C-B, që të gjithë nga Rahoveci, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. A.D-B nga Prishtina, ndaj të paditurës I me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.L, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit prej 34,253.00 euro, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 27.05.2024 mori, ndërsa më datën 12.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësve A.B, A.C-B dhe i mituri R.B, të cilin e përfaqëson, përfaqësuesja ligjore, e ëma A.C-B, që të gjithë nga Rahoveci.

II. DETYROHET e paditura I me seli në Prishtinë, që paditësit A.B, në emër të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e trafikut rrugor të datës 21.03.2022, në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, në automjetin e markës “O”, me targa ..., t’ia kompensojë shumën prej 5,878.40 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 12.09.2022 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura I me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 21.03.2022, në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, paditësin A.B, në emër të dëmit jo material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike.....1,500.00 euro.
- Në emër të frikës së përjetuar.....1,600.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 3,100.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura I me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 21.03.2022, në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, paditësin A.B, në emër të dëmit material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë.....150.00 euro.
- Në emër të ushqimit të përforcuar (90 ditë).....100.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 250.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 12.09.2022 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim.

V. DETYROHET e paditura I me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 21.03.2022, në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, paditëses A.C-B, në emër të dëmit jo material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike.....1,600.00 euro.
- Në emër të frikës së përjetuar.....1,500.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 3,100.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

VI. DETYROHET e paditura I me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 21.03.2022, në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, , paditëses A.C-B, në emër të dëmit material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë.....150.00 euro.
- Në emër të ushqimit të përforcuar (90 ditë).....100.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 250.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 12.09.2022 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim.

VII. DETYROHET e paditura I me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 21.03.2022, në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, paditësit të miturit R.B, në emër të dëmit jo material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike.....1,800.00 euro.
- Në emër të frikës së përjetuar.....1,800.00 euro.
- Në emër të shëmtimit.....1,500.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 5,100.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

VIII. DETYROHET e paditura Ime seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datën 21.03.2022, në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, paditësit të miturit R.B, në emër të dëmit material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë.....200.00 euro.
- Në emër të ushqimit të përforcuar (90 ditë).....100.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 300.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 12.09.2022 (data e parashtrimit të padisë), e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim.

IX. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve paditësve A.B, A.C-B dhe R.B, përtej shumave të aprovuara si në pikën III, IV dhe V të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

X. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve A.B, A.C-B dhe R.B, në emër të kompensimit të dëmit për rehabilitim fizioterapeutik në tërësi si e pa bazuar.

X. DETYROHET e paditura I me seli në Prishtinë, që paditësve A.B, A.C-B dhe R.B, t'ua paguajë shpenzimet procedurale në shumën prej 2,928.40 euro po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit A.B, A.C-B dhe i mituri R.B, të cilin e përfaqëson, përfaqësuesja ligjore, e ëma A.C-B, që të gjithë nga Rahoveci, përmes përfaqësueses të tyre të autorizuar, më datën 12.09.2022 në këtë gjykata kanë parashtruar padinë ndaj të paditurës I me seli në Prishtinë, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jomaterial, me vlerën e objektit të kontestit 34,253.00 euro, e precizuar me parashtresën e datës 27.05.2024.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditësve Av. A.D-B, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. E njëjta ka theksuar se e kanë pranuar përgjigjen në padi, e paditura në procedurë sipas kërkesës për shpërblimin e dëmit, tani edhe në përgjigje në padi e ka pohuar përgjegjësinë civile juridike, për shpërblimin e dëmit. Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe meqenëse paditësit kanë pësuar lëndime të llojeve të ndryshme, gjykatës i ka propozuar marrjen provës me ekspertizë për tre paditësit dhe atë nga lëmi i ortopedisë, për vlerësimin e kategorive të lëndimeve të pësuar si dhe nga lëmi e psikiatrisë për vlerësimin e frikës së përjetuar, ndërsa për ekspert ka propozuar ortopedin Dr. Xh.S, ndërsa për psikiatër Dr. N.M, që të dy nga Prishtina. Gjithashtu, gjykatës i ka propozuar që për vërtetimin e saktë dhe të drejtë, sa i përket vëllimit të dëmit në automjetin e paditësit A.B, të nxjerrët prova përmes ekspertizës së makinerisë dhe për ekspert ka propozuar mrs.sc. B.K, ekspert gjyqësor në fushën e makinerisë dhe ekspert i trafikut rrugor. Pas pranimit të këtyre ekspertizave e njëjta ka theksuar se ndaj të njëjtave nuk kanë vërejtje e as pyetje. Duke shtuar se nga provat e administruara është vërtetuar se paditësit në ditën kritike kanë pësuar lëndime trupore të formave të ndryshme, si dhe dëme materiale në veturën e paditësit të parë, e të cilat nga provat e është vërtetuar se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e këtij dëmi. Meqenëse në rastin konkret janë nxjerrë dy ekspertiza për vlerësimin e dëmit material, si dhe meqenëse ekspertiza e datës 30.11.2023 është më e përafërt

për vlerësimin e dëmit real në automjet, pasi që e përfaqëson në tërësi ekspertizën, mënyrën e punës, krahasimin e çmimeve të tregut, shembujt konkret mbi bazën e të cilëve eksperti ka dhënë mendimin konkret mbi vlerën reale të tregut të veturës, andaj i ka propozuar gjykatëse që kësaj ekspertize të ia fal besimin e plotë. Ndërsa ekspertizës të datës 19.03.2024, të mos ia fal besimin, pasi që e njëjta është e mangët jo e plotë dhe nuk ka arsye të mjaftueshme mbi bazën e të cilës eksperti ka ardhur në përfundim për caktimin e vlerës së veturës eksperti është bazuar në kontratën e paditësit për shitë – blerjen e veturës, kjo nuk mund të mirët si masë matëse e çmimit që është vendosur, pasi që paditësi veturën e ka blerë shumë më lartë se çmimi që është vendosur në kontratë, që çmimi është vendosur në atë shumë për shkaqe personale të shitësit dhe blerësit, por dihet botërisht se çmimi nuk është i saktë. Po ashtu e njëjta ka theksuar se natyra, vendi, mosha dhe lloji i lëndimeve të cilët iu janë shkaktuar paditësve kanë ndikuar dhe ndikojnë në mënyrën të drejtpërdrejt në zhvillimin normal të jetës së tyre. Frika që kanë përjetuar paditësit në momentin e aksidentit është manifestuar në forma të ndryshme duke u nisur nga frika për vdekjen, invaliditetin e përhershëm, e të cilët kanë ndikuar që paditësit të mos jenë të sigurt në vetveten për të dal në komunikacion. Kërkesëpadia e paditësve për shpërblimin e dëmit paraqet një kërkesë reale, ndërsa shumat e kërkuara përfaqësojnë një satisfaksion moral duke pasur parasysh rendësin e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e precizuar të paditësve ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës A.L, në përgjigjen në padi, në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigje në padi, duke ritheksuar se bazën juridike të padisë që ka të bëj me përgjegjësinë në shkaktimin e dëmit nuk e kontestojnë, si dhe nuk i ka kundërshtuar provat e propozuara që kanë të bëjnë me ekspertizat si dhe emrat e propozuara të eksperteve. Ndërsa pas pranimit të ekspertizave i njëjti ka theksuar se nuk kanë vërejtje sa i përket mendimit të ekspertëve mjekësorë, ndërsa kanë vërejtje për mendimin e ekspertit të makinerisë. Duke shtuar se në këtë çështje kontestimore, mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese baza juridike e padisë, por kontestuese kanë qenë pretendimet e paditësve lidhur me lartësinë e dëmit material dhe jomaterial të cilin e kanë pësuar, si dhe natyrën e lëndimeve. Lidhur me ekspertizën e makinerisë të ekspertit B.K, i njëjti ka theksuar se me rastin e dhënies së mendimit nuk ka qenë shumë transparent lidhur me vlerësimin e këtij dëmi duke mos pasqyruar në ekspertizë të gjitha burimet e vlerësimit të dëmit, gjithashtu eksperti ka marrë si referencë kryesore automjetin në vitin 2024 i cili në kushtet e tanishme siç e ka bërë vlerësimin nuk lejohet të importohet në Kosovë për shkak të vjetërsisë. Automjeti për të cilën kërkohet kompensim dëmi në bazë të kontratës mbi shitblerjen e automjetit të noterizuar me Nr. Ref: 0484/2017, të datës 03.10.2017, në mes të shitësit Sh.T dhe paditësit A.B është vlerësuar në vlerën 9,000.00 euro, ndërsa aksidenti i komunikacionit ka ndodhur afër 5 vjet më vonë. Andaj ka propozuar që të nxjerrët një ekspertizë e re nga lëmi i makinerisë, ndërsa për ekspert ka i propozoj Ing. S.B. Lidhur me precizimin e kërkesëpadisë, të njëjtin e kontestojnë pjesërisht dhe atë sa i përket paditësit A.B, lidhur me shumën e kërkuar për automjet, e cila është e bazuar në mendimin e ekspertit B.K, përfundimet e kësaj ekspertize nuk kanë profesionale, të mangëta dhe jo të bazuara në vlerën e automjetit në ditën e aksidentit, prandaj për këtë formë të dëmit, me rastin e vendosjes, gjykatës i ka propozuar që kompensimin e dëmit material në automjet

paditësit A.B, të ia njoh në shumën prej 5,878.40 Euro, e vlerësuar nga eksperti i makinerisë S.B, i cili sot në aspektin faktik dhe shkencor, argumentoi vlerën reale të këtij automjeti. Lidhur me precizimin e kërkesëpadisë për të gjithë paditësit, sa i përket dëmit për lëndime trupore, gjegjësisht dëmit jomaterial, si dhe dëmit material në emër të ndihmës së personit të huaj dhe ushqimit të përforcuar, e kontestojnë pjesërisht me arsyetimin se këto shuma nuk janë të bazuara, marrë parasysh praktikën gjyqësore dhe shkallën e lëndimit për paditësit, ndërsa kërkesëpadinë për dëmin material për rehabilitim fizio-terapeutik për secilin paditës, nga 150.00 Euro, e kontestojnë në tërësi dhe i kanë propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzojë në tërësi si të pabazuar, me arsyetimin se nuk ka prova materiale në shkresat e lëndës se paditësit kishin shpenzime të tilla. Po ashtu, e kanë kontestuar precizimin sa i përket kohës së rrjedhjes së kamatës, gjykatës i kanë propozojmë që me rastin e vendosjes në këtë çështje, kamatën për dëmin jomaterial ta gjykojë nga data e marrjes së aktgjykimit, ndërsa për dëmin material nga data e ushtrimit të padisë. Gjykatës i ka propozuar që shpenzimet e procedurës kontestimore të gjykohen në bazë të parimit të suksesit në procedurë, me arsyetimin se në këtë çështje kontestimore nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por lartësia e saj. Gjykata ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, konform nenit 258.1 të LPK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 23.02.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: raportin e aksidentit me nr. 2022-ER-138, i datës 21.03.2022, i hartuar nga Policia e Kosovës në Gjakovë; parashtresën e datës 29.04.2022, e të paditurës, që i është dorëzuar paditësit A.B; parashtresë e datës 05.07.2022, e të paditurës, që i është dorëzuar paditësit A.B; procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit, të I, e datës 31.03.2022, me të dëmtuar A.B, për veturën me nr. identifikues të automjetit; raportin nga konsulta, i datës 20.05.2022, për paditësin A.B, me faksimil të padalluar të mjekut; dëftesat me nr. serik: 00142450, 00142449 dhe 00142441, të lëshuara nga Spitali Regjional Gjakovë; raportin nga konsulta, i datës 06.04.2022, për paditësin A.B, me faksimil të Dr. H.P, specialiste e psikiatrisë; Raport nga konsulta, i datës 23.03.2022, për paditësin A.B, me faksimil të Dr. B.R, specialist i psikiatrisë; raportin nga konsulta, i datës 29.03.2022, për paditësin A.B, me faksimil të Dr. H.P, specialiste e psikiatrisë; raportin nga Reparti i Emergjencës, me nr. vendor 3356, të Spitalit Rajonal “Isa Grezda”, në Gjakovë, i datës 21.03.2022, ora 21:22, për paditësin A.B, me faksimil të Dr. V.S, specialist i kirurgjisë së përgjithshme; kërkesën për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, e datës 04.05.2022, të parashtruar nga paditësi R.B, ndaj të paditurës; raportin nga Reparti i Emergjencës, me nr. vendor 3355, i Spitalit Rajonal “Isa Grezda”, në Gjakovë, i datës 21.03.2022, ora 21:22, për paditësin R.B, me faksimil të Dr. V.S, specialist i kirurgjisë së përgjithshme; parashtresën e datës 28.07.2022, të të paditurës, që i është dorëzuar paditësit R.B; raportin nga konsulta, i datës 20.05.2022, për paditësin R.B, me faksimil të Dr. H.P; dëftesat me nr. serik: 0119344, 00121902 dhe 00121901, të lëshuara nga Spitali Regjional Gjakovë; raportin nga konsulta, i datës 23.03.2022, për paditësin A.B, me faksimil të Dr. H.P, specialiste e psikiatrisë; raportin nga konsulta, i datës 06.04.2022, për paditësin R.B, me faksimil të Dr. H.P, specialiste e psikiatrisë; raportin nga konsulta, i datës 29.03.2022, për paditësin R.B, me faksimil të Dr. H.P, specialiste e psikiatrisë; kërkesën për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, e paditëses A.C, e datës 04.05.2022; përgjigjen e të paditurës, ndaj paditëses A.C, e

datës 28.07.2022; raportin nga konsulta, për paditësen A.B.C, i datës 20.05.2022, me faksimil të Dr. H.P, specialiste e psikiatrisë; raportin nga konsulta, për paditësen A.B.C, i datës 06.04.2022, me faksimil të Dr. H.P, specialiste e psikiatrisë; raportin nga konsulta, për paditësen A.B.C, i datës 29.03.2022, me faksimil të Dr. H.P, specialiste e psikiatrisë; Raport nga konsulta, për paditësen A.B.C, i datës 23.03.2022, me faksimil të Dr. B.R, specialist i psikiatrisë; raportin nga Reparti i Emergjencës, i datës 20.05.2022, ora 21:22, me nr. vendor 3357, dupilkat i datës 21.03.2022, për paditësen A.C, i lëshuar nga Spitali Rajonal "Isa Grezda", në Gjakovë; raportin kthyes nga diagnostika me nr. serik 0016290, i datës 23.03.2022, për paditësen A.C, me faksimil të Dr. I.E; dëftesat me nr. serik: 0152514, 0152513 dhe 0140611, të lëshuara nga Spitali Regjional Gjakovë; raportin nga Reparti i Emergjencës, i datës 21.03.2022, ora 21:22, me nr. vendor 3357, për paditësen A.C, i lëshuar nga Spitali Rajonal "Isa Grezda", në Gjakovë; dëftesat me nr. serik: 00142440, 00121903 dhe 00142446, të lëshuara nga Spitali Regjional Gjakovë; ekspertizën e vlerësimit të dëmit, e datës 30.11.2023, e ekspertit të makinerisë B.K; ekspertizën e ortopedisë dhe psikiatrisë, e dorëzuar përmes postës nga ekspertët: Dr. Xh.S dhe Dr. N.M, e pranuar nga kjo gjykatë me datë 20.12.2023; kontratë mbi shitblerjen e automjetit, me nr. LRP.nr.2945/2017, ref.nr. 0484/2017, e datës 03.10.2017, e përpiluar nga noterja L.F.C, në Prishtinë; ekspertizë e makinerisë, e ekspertit S.B, e pranuar nga kjo gjykatë me datë 22.03.2024 dhe Aktgjykimin K.nr.02-171/2022, i Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, i datës 06.05.2022.

Gjykata në këtë çështje kontestimore, gjithashtu ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i ortopedisë – traumatologjisë, psikiatrisë dhe makinerisë, ku për ekspert të ortopedisë – traumatologjisë është caktuar Dr. Xh.S, për ekspert të psikiatrisë është Dr. N.M, ndërsa për ekspert të makinerisë është caktuar B.K. Pasi që ndaj ekspertizës të makinerisë, të ekspertit B.K, pala e paditura kishte vërejtje, sipas propozimit të saj gjykata ka caktuar që të nxirret edhe një ekspertizë e makinerisë, ndërsa për ekspert është caktuar S.B.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 7 dhe 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se me datën 21.03.2022, rreth orës 20:00 min, në fshatin Brestoc, Komuna e Rahovecit, është shkaktuar aksidenti i trafikut me dëme materiale dhe jo materiale ndërmjet paditësit dhe të siguarit të paditëses, fakt i cili është vërtetuar edhe nga raporti policor i datës 21.02.2022, i Stacionit Policor Gjakovë.

Në këtë çështje kontestimore kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse, kontestuese mbetet lartësia e kërkesës së paditësve.

Me administrimin ekspertizës se komunikacionit të ekspertit B.K, të dorëzuar në gjykatë me datën 30.11.2023, si dhe sqarimeve të ekspertit në seancën e shqyrtimit kryesor të 11.03.2024, gjykata vërtetoi faktin se sipas kësaj ekspertize në bazë të shkresave të lëndës, hulumtimet në internet në tregun vendor dhe atë të jashtëm, vitin e prodhimit të automjetit dhe kohën e aksidentit është konstatuar se Automjeti "O I", me targa të regjistrimit ..., në aksidentin e trafikut i është shkaktuar dëmi material në vlerën prej 9,603. 00 euro. I njëjti në ekspertizë ka theksuar se çmimi i veturës së eksportuar me të gjitha shpenzimet tjera deri në daljen në qarkullim me targa të

Kosovës sipas ofertës që ka prezantuar në ekspertizë është kalkuluar 12,582.00 euro. Krahasimi i kësaj vlere me ofertën në tregun vendor ka marrë një mesatare të arsyeshme prej 11,000.00 euro të cilës i kam zbritur pjesët e mbetura sipas tabelës B në faqen 12 dhe kam konstatuar që vlera e dëmit duke hequr pjesët e mbetura është 9,603.00 euro, ndërsa lidhur me nxjerrjen e ekspertizës së vlerësimit të dëmit nuk është marr për bazë apo çmimi i blerjes së veturës nga ana e të paditësit A.B. Po ashtu nga deklarami i ekspertit është konstatuar se në kohën kur keni bërë llogaritjen e dëmit, automjetit që janë ka cekur nga faqja e internetit në Kosovë, të njëjta nuk janë inkuorporuar në ekspertizë. Gjykata kësaj ekspertize nuk ia fali besimin, pasi që e njëjta nuk ka me rastim e caktimit të vlerës së dëmit nuk ka marr parasysh, veturat e llojtoit të njëjtë në Kosovë, por edhe nga vetë kontrata për shitblerjen e automjetit LRP.nr.2945/2017, ref.nr.0484/2017 të datës 03.10.2017, çmimin e automjetit në vitin 2017, kur është kryer shitblerja ndërmjet palëve, është përcaktuar në shumën prej 9,000.00 euro.

Me administrimin ekspertizës se komunikacionit të ekspertit S.B, të dorëzuar në gjykate me datën 22.03.2024, si dhe sqarimeve të ekspertit në seancën e shqyrtimit kryesor të 27.05.2024 (të cilëve gjykata ia dha besimin e plotë), gjykata vërtetoi faktin se sipas kësaj ekspertize është konstatuar se automjetit të markës “O – I – S A”, në aksidentin e trafikut, i janë shkaktuar dëme të mëdha teknike, ndërsa pas riparimit nuk garanton siguri për eksploatim në komunikacion, si dhe është konstatuar se automjeti ka pësuar dëm total teknik. Analiza për vlerën reale të automjetit në kohën e aksidentit është bërë duke analizuar dy variante A1 dhe A2. Sipas variantit A1 është marr mesatarja nga disa oferta sipas tregut në Kosovë, ndërsa sipas variantit A2 është analizuar vlera e automjetit të ri sipas çmimit bazë, dhe i është zbritur amortizimi sipas standardeve për kohën e shfrytëzimit - amortizimit (13 vite). Sipas mesatares të dy varianteve (A1 dhe A2) dhe është gjendur vlera reale e automjetit në kohën e aksidentit, siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme. Pas aksidentit, në automjet kanë mbetur edhe mbeturinat, të cilat janë llogaritur sipas tabelave shkencore për mbetje, e cila mbetje i është zbritur vlerës së automjetit. Përfundimisht ekspertiza, duke marr për bazë numrin e shasisë së automjetit përmes programit VIN DECODER, si deh duke e analizuar automjetin real me të gjitha karakteristikat e tij të cilat i posedon nga fabrika, pastaj gjatë analizës së automjetit, janë shikuar disa automjete të ngjashme, afërsisht të njëjta me automjetin real, duke e ditur edhe vjetërsinë e tij, prej 13 viteve, mendoj se afërsisht është ky çmim siç është cekur në ekspertizë sipas kësaj përllogaritjes ka konstatuar se vlera e dëmit material, të cilit i është shkaktuar automjetit në kohën e aksidentit është shuma prej 5,878.40 euro.

Gjykata ekspertizën e punuar nga i eksperti i komunikacionit S.B, e vlerëson si profesionale, të argumentuar mirë dhe të njëjtës ia fali besimin e plotë, ngase e njëjta ka paraqitur vlerësime profesionale lidhur me dëmin e shkaktuar në automjetin i cila është objekti i kompensimit të dëmit në këtë çështje kontestimore.

Me administrimin e mendimit e përbashkët të ekspertit të ortopedisë dhe traumatologjisë Dr. Xh.S dhe ekspertes psikiatër Prof. Ass. N.M të dorëzuar në gjykatë me datën 20.12.2023, (të cilit gjykata ia dha besimin e plotë) gjykata vërtetoi faktin se duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës dhe ekzaminimeve të drejtpërdrejtë të paditësve me datën 30.11.2023, është konstatuar se paditësi A.B në aksidentin e trafikut të datës 21.03.2022 ka

pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të kokës dhe të regjionit të bylyzykut të dorës së majtë, ndërsa këto lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Ndërsa në momentin e pësimit të lëndimit i janë shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, në kohëzgjatje prej 15 minuta. Dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, në kohëzgjatje prej 24 orë kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditë, kohë e nevojshme për rikuperimin nga lëndimet e kokës dhe bylyzykut të dorës së majtë. Dhimbje të intensitetit më të ultë sipas të dhënave anamnesticke ka pasur dhimbje koke dhe të bylyzykut të dorës së majtë edhe një muaj e gjysme pas aksidentit. Ndërsa sa i përket frikës i njëjti ka pësuar: Frikë primare që ka zgjatë për disa sekonda në momentin e aksidentit, e manifestuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të tij fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë, në kohëzgjatje prej 2 ditëve, e shoqëruar me gjendje të reagim të akut në stres, ankthe, pagjumësi, rikujtime të ngjarjes traumatike, frikës nga pasojat e mundshme të aksidentit, për çka edhe është vizituar te psikiatri, i cili i ka përshkruar terapi adekuate qetësuese dhe antidepresive, kundër stresit si pasojë e çrregullimit të përshtatjes pas traumës së përjetuar. Frikë të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 4 javëve, në formë të brengës për ecurinë e mjekimit, anktheve të herëpashershme, indisponimit, nervozes, vështirësive të adaptimit si dhe pasigurisë gjatë pjesëmarrjes në komunikacion me çrregullime të përshtatjes, bazuar në raportet psikiatrike që gjenden në shkresat e lëndës, ku edhe i është përshkruar terapi adekuate. Ndërsa frikë të intensitetit të ulët, ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 muajve, e cila është shoqëruar me brengën e herëpashershme për ecurinë e mjekimit, shqetësimeve gjatë gjumit dhe nervozes, mungesë të vullnetit dhe të disponimit, pasigurisë sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion, si dhe pasojave të çrregullimet pas traumës për çka marr terapinë e ordinuar nga psikiatri. Po ashtu është konstatuar se nuk ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm dhe të shëmtim trupor. Përkujdesja e personit të tret ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditëve, që konsiston në ndihmën e në aktivitetet të përditshme jetësore, siç janë ushqimi, veshmbathja higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshme për 20 ditë, i pasur me proteina, mineral dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshëm, ndërsa rehabilitimi i fizioterapeutik kas qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh brenda vitit të parë pas aksidentit. Padiësja A.C - B, në aksidentin e trafikut të datës 21.03.2022 ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të kokës dhe të gjurit të majtë, të cilat lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Në momentin e pësimit të lëndimit i janë shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, në kohëzgjatje prej 10 minutave. Dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, në kohëzgjatje prej 24 orë, kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditë, kohë e nevojshme për rikuperimin nga lëndimet e kokës dhe bylyzykut të gjurit të majtë. Dhimbje të intensitetit më të ultë sipas të dhënave anamnesticke, aktualisht ankon për dhimbje të lehta të gjurit të majt, të cilët janë më të shprehura në ndryshime klimatike, si dhe është ankuar që ka pasur ushtimë në vesh për 3 – 4 muaj pas aksidentit. Ndërsa sa i përket frikës i njëjti ka pësuar: Frikë primare që ka zgjatë për disa sekonda në momentin e aksidentit, e manifestuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të tij fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë, në kohëzgjatje prej 2 ditëve, e shoqëruar me gjendje të reagim të akut në stres, anktheve, pagjumësisë, rikujtime të ngjarjeve traumatike, frikës nga pasojat e aksidentit, për çka edhe është vizituar te psikiatri, i cili i ka përshkruar terapi adekuate qetësuese dhe antidepresive. Frikë të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 4 javëve, në formë

të brengës për ecurinë e mjekimit, anktheve të herëpashershme, indisponimit, nervozes, vështirësive të adaptimit, me çrregullime të përshtatjes nga pasojat e traumës së përjetuar, si dhe pasigurisë gjatë pjesëmarrjes në komunikacion, me ç'rast është vizituar në kontrollet të rregullta edhe te psikiatri, ku edhe i është përshkruar terapi adekuate. Ndërsa frikë të intensitetit të ulët, ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3 muajve, e cila është shoqëruar me brengën e herëpashershme për ecurinë e mjekimit, shqetësimeve gjatë gjumit dhe nervozes, mungesë të vullnetit dhe të disponimit, pasigurisë sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion dhe manifestimeve të çrregullimit të stresit pas traumatik për çka i është ordinuar edhe terapi qetësuese dhe antidepressive kundër stresit, bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës. Është konstatuar se nuk ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm dhe të shëmtim trupor. Përkujdesja e personit të tret ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditëve, që konsiston në ndihmën e në aktivitetet të përditshme jetësore, siç janë ushqimi, veshmbathja higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshme për 20 ditë, i pasur me proteina, mineral dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshëm, ndërsa rehabilitimi i fizioterapeutik kas qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh brenda vitit të parë pas aksidentit. Padiësja i mituri R.B, në aksidentin e trafikut të datës 21.03.2022 ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të kokës e shoqëruar me plagë prerëse dërmishëse në cepin e brendshëm të vetullës së majtë, të cilat lëndime karakterizohen si lëndime të lehta trupore. Në momentin e pësimit të lëndimit i janë shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, që kanë zgjatur për 15 minuta. dhimbje fizike të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur për 24 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur për 14 ditë, kohë e nevojshme për rikuperimin nga lëndimet ndrydhëse dhe plaga prerëse e kokës dhe vetullës së majtë. Dhimbje fizike të intensitetit më të ultë sipas të dhënave heteroanamnestike nga nëna e tij, fëmiju ka pasur dhimbje në regjionin e kokës për rreth tre javë. Sa i përket frikës konstatojmë se i njëjti ka pësuar: Frikë primare që ka zgjatë për disa sekonda në momentin e aksidentit, e manifestuar në formë të frikës nga kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të tij fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 3 dite, duke marrë parasysh moshën, e shoqëruar me gjendje të reagimit akut në stres me shpërthime emocionale dhe të quajtura si pasojë e lëndimit dhe gjakosjes ku është dashtë të bëhet qepja e plagës, e cila i ka shkaktuar ankthe dhe stres intensiv, vështirësi gjatë gjumit me zgjime të shpeshta, mungesë disponim për çka është vizituar nga psikiatri, i cili i ka përshkruar diagnozën reagim akut në stres dhe rekomandim të terapisë vitaminoze dhe seancës psikoterapeutike. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur për 4 javë, me manifestime të çrregullimit të përshtatjes dhe simptome të ankthit, indisponimit, zgjimeve të shpeshta gjatë natës me ëndrra të këqija, nervozës, urinimit të pakontrolluar gjatë natës për shkak të reagimeve emocionale me fobi ndaj ekzaminimeve mjekësore, për çka është vizituar nga psikiatri, ku i është përshkruar terapi vitaminoze, bazuar në raportet që gjenden në shkresa të lëndës. Frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka zgjatur për 4 muaj, e shoqëruar me gjendje të çrregullimit të përshtatjes dhe vështirësive të adaptimit nga pasojat e traumës psikike nëpër të cilën ka kaluar, indisponimit, nervozës, fobisë ndaj kontrollova mjekësore, si dhe pasigurisë gjatë pjesëmarrjes në komunikacion me ç'rast i është ordinuar edhe terapi adekuate suplementare me vitamina nga psikiatri. Është konstatuar se zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka, ndërsa shëmtim trupor ka në shkallë të ulët për shkak të vrazës me gjatësi prej 2 cm, në cepin e brendshëm të vetullës së majtë, e cila është në pozicion të dukshëm dhe që shihet vazhdimisht.

Përkujdesja e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 14 dite, që konsiston në ndihmën në aktivitete të përditshme jetësore, siç janë ushqimi, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqim i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 21 ditë, i pasur me proteina, minerale dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshmi, ndërsa rehabilitim fizioterapeutik klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 7 ditëve brenda vitit të parë pas aksidentit.

Me administrimin e kontratë mbi shitblerjen e automjetit, me nr. LRP.nr.2945/2017, ref.nr. 0484/2017, e datës 03.10.2017, e përpiluar nga noterja L.F.C, në Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi A.B, automjetin “O”, e ka blerë me çmim prej 9.000 euro.

Me administrimin e Aktgjykimit K.nr.02-171/2022, i Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, i datës 06.05.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se i siguruari i të paditurës është shpallur fajtor për aksidentin e shkaktuar me datë 21.03.2022, dhe të njëjtit i është shqiptuar gjobë në shumën prej 150.00 euro.

Gjykata vendosi ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve për faktin se sipas vlerësimit të saj në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit material dhe jo material, si pasojë e aksidentit të komunikacionit. Se ky aksident është shkaktuar si rezultat i lëshimeve të të siguarës të të paditurës, nuk është kontestuar edhe nga e njëjta. Baza juridike e kërkesëpadisë buron nga neni 136 i LMD-së, ku parashihet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa neni 140 e të njëjtit ligj parasheh se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Po ashtu, në nenin 159 par. 1 të LMD-së *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”*.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me dëmin material në automjeti e paditësit A.B, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e kompensuar paditësin në shumën prej 5,878.40 euro, pasi që sipas vlerësimit të ekspertizës për vlerësimin të dëmit të ekspertit S.B është konstatuar se dëme materiale në automjetit të markës “O – I – S A”, pronë e paditësit A.B, në aksidentin e trafikut, të datë 21.03.2022, i janë shkaktuar dëme të mëdha teknike, si dhe është konstatuar se automjeti ka pësuar dëm total teknik. Përfundimisht ekspertiza, duke marr për bazë numrin e shasisë së automjetit përmes programit VIN DECODER, si dhe duke e analizuar automjetin real me të gjitha karakteristikat e tij të cilat i posedon nga fabrika, pastaj gjatë analizës së automjetit, janë shikuar disa automjete të ngjashme, afërsisht të njëjta me automjetin real, duke e ditur edhe vjetërsinë e tij, prej 13 viteve, mendoj se afërsisht është ky çmim siç është cekur në ekspertizë sipas kësaj përlllogaritjes ka konstatuar se vlera e dëmit material, të cilit i është shkaktuar automjetit në kohën e aksidentit është shuma prej 5,878.40 euro. Ekspertizën e ekspertit S.B gjykata e vlerësoi si profesionale, të argumentuar mirë dhe të njëjtës ia fali besimin e plotë, ngase e njëjta ka paraqitur vlerësime profesionale lidhur me rastin. Andaj, gjykata ka vendosur që në emër të dëmit material të shkaktuar në automjet paditësin A.B, ta kompensoj në shumën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me dëmin jomaterial, gjykata ka vendosur që këto lëndime trupore të i trajtojë si lëndime të lehta trupore për shkakun se nga ekspertiza e ekspertit

ortoped – traumatolog, Dr. Xh.S dhe ekspertes nga lëmi i psikiatrisë Dr. N.M, këto lëndime janë kategorizuar si lëndime të lehta trupore. Në këtë rast, gjykata ka vendosur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se shumata e vendosura të jenë një satisfaksion për paditësit dhe se këto shuma janë vendosur në pajtueshmëri të plotë me praktikën gjyqësore. Në këtë rast, gjykata vendosi që paditësit A.B të ia aprovojë kërkesëpadinë si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, në emër të dhimbjeve fizike në shumën prej 1,600.00 euro, për shkak e në bazë të ekspertizës, paditësi A.B në aksidentin e trafikut të datës 21.03.2022 ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje të kokës dhe të regjionit të bylyzykut të dorës së majtë, ndërsa këto lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore. Ndërsa në momentin e pësimit të lëndimit i janë shkaktuar dhimbje siç janë përshkruar në ekspertizë dhe atë dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, në kohëzgjatje prej 15 minuta. Dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, në kohëzgjatje prej 24 orë kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditë, kohë e nevojshme për rikuperimin nga lëndimet e kokës dhe bylyzykut të dorës së majtë. Dhimbje të intensitetit më të ultë sipas të dhënave anamnestike ka pasur dhimbje koke dhe të bylyzykut të dorës së majtë edhe një muaj e gjysme pas aksidentit. Gjithashtu, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të frikës si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, në shumën prej 1,600.00 euro për shkak se paditësi A.B në momentin e aksidentit ka përjetuar ka pësuar siç është përshkruar në ekspertizë dhe atë, frikë primare që ka zgjatë për disa sekonda në momentin e aksidentit, e manifestuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të tij fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë, në kohëzgjatje prej 2 ditëve, frikë të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 4 javëve. Ndërsa frikë të intensitetit të ulët, ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 muajve. e cila është shoqëruar me brengën e herëpashershme për ecurinë e mjekimit, shqetësimeve gjatë gjumit dhe nervozes, mungesë të vullnetit dhe të disponimit, pasigurisë sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion, si dhe pasojave të çrregullimet pas traumës për çka marr terapinë e ordinuar nga psikiatri. Në këtë rast, gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, që paditëses A.C - B të ia aprovojë kërkesëpadinë në emër të dhimbjeve fizike në shumën prej 1,600.00 euro, pasi që në aksidentin e trafikut të datës 21.03.2022, në momentin e pësimit të lëndimit i janë shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, në kohëzgjatje prej 10 minutave. Dhimbje fizike të intensitetit të rëndë, në kohëzgjatje prej 24 orë, kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditë, kohë e nevojshme për rikuperimin nga lëndimet e kokës dhe bylyzykut të gjurit të majtë. Dhimbje të intensitetit më të ultë sipas të dhënave anamnestike, aktualisht ankon për dhimbje të lehta të gjurit të majtë. Gjithashtu, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë si në pikën VI të dispozitivit të aktgjykimit dh atë në emër të frikës në shumën prej 1,600.00 euro për shkak se paditësja ka përjetuar frikë siç është konstatuar në ekspertizë dhe atë: frikë primare që ka zgjatë për disa sekonda në momentin e aksidentit, e manifestuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të tij fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë, në kohëzgjatje prej 2 ditëve, frikë të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 4 javëve. Ndërsa frikë të intensitetit të ulët, ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3 muajve. Në këtë rast, gjykata vendosi si në pikën VII, të dispozitivit të aktgjykimit që paditësit të miturit R.B të ia aprovojë kërkesëpadinë në emër të dhimbjeve fizike në shumën prej 1,800.00 euro, pasi që të njëjtit në momentin e pësimit të lëndimit i janë shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, që kanë zgjatur për 15 minuta. dhimbje fizike të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur për

24 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur për 14 ditë, kohë e nevojshme për rikuperimin nga lëndimet ndrydhëse dhe plaga prerëse e kokës dhe vetullës së majtë. Dhimbje fizike të intensitetit më të ultë sipas të dhënave heteroanamnestike nga nëna e tij, fëmiu ka pasur dhimbje në regjionin e kokës për rreth tre javë. Gjithashtu, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit të miturit R.B në emër të frikës si në pikën VIII, të dispozitivit të aktgjykimit, në shumën prej 1,800.00 euro për shkak se paditësja ka përjetuar frikë siç është konstatuar në ekspertizë dhe atë: Frikë primare që ka zgjatë për disa sekonda në momentin e aksidentit, e manifestuar në formë të frikës nga kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të tij fizik. Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur për 3 dite. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm që ka zgjatur për 4 javë, frikë sekondare të intensitetit të ulët që ka zgjatur për 4 muaj. Gjithashtu, gjykata ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit të miturit R.B, në emër të shëmtimit trupor për shkak në shumë prej 1,500.00 euro, pasi që paditësi ka përjetuar shkallë të ulët të shëmtimit për shkak të vrazës me gjatësi prej 2 cm, në cepin e brendshëm të vetullës së majtë, e cila është në pozicion të dukshëm dhe që shihet vazhdimisht. Baza juridike e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit buron në nenin 183 par.1 të LMD-së, sipas të cilit *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*, ndërsa sipas nenit 174 të LMD-së përcaktohet që *“Gjykata duke marr parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkakimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues”*. Me rastin e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit të dëmit, gjykata kishte parasysh edhe shkallën e dëmit që i është shkaktuar paditësit, ndërsa kjo buron në nenin 183 par.2 të LMD-së, sipas të cilit *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Për të gjitha këto kategori, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, për shpërblimin e dëmit në rastin konkret gjykata ka vendosur sipas çmuarjes së lirë, e kjo duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, sipas të cilit *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tilla do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*.

Sa i përket dëmit material, gjykata ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë dhe atë për paditësit A.B dhe A.C-B, në emër të përkujdesjes të personit të tretë, ti kompensojë në shumën 150.00 euro, për secilin prej tyre veç e veç, ndërsa paditësit të miturit R.B në shumën prej 200.00 euro, pasi siç edhe është konstatuar me ekspertizë ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme te paditësit A.B dhe A.C-B, në kohëzgjatje prej 14 dite, ndërsa te paditësi i mituri R.B në kohëzgjatje prej 21 dite, që konsiston në ndihmën në aktivitete të përditshme jetësore, siç janë ushqimi, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Gjykata vendosi që në emër

të kompensimit të dëmit për ushqimit të përforcuar secilit paditës ti kompensoj shumë prej 100.00 euro, pasi që është konstatuar se tek të njëjti pas aksidenti, ushqim i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 21 ditë, i pasur me proteina, minerale dhe vitamina, ushqim më i përforcuar se ai i zakonshmi. Andaj gjykata konsideron se shumat si të tilla janë në pajtueshmëri me dëmin material që i është shkaktuar paditësve.

Gjykata ka vendosur sikurse në të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se sipas vlerësimit të saj me shumat e aprovuara, arrihet kompensimi i nevojshëm në lidhje me dëmin që i është shkaktuar paditësve në aksidentin që është objekt i këtij kontesti. Vlerat e aprovuara janë në harmoni të plotë me pritshmërinë e krijuar në rastin konkret, prandaj edhe ka vendosur që ta refuzojë shumë përtej shumave të aprovuar. Me rastin e vendosjes, gjykata pati për bazë shkallën e lëndimit, natyrën e lëndimit, moshën e paditësve që në rastin konkret janë të dëmtuar, por që shuma janë dukshëm më e lartë nga ajo që gjykata vlerëson se në rastin konkret do të jetë satisfaksion për dëmin e shkaktuar jo material.

Gjykata vendosi ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e dëmit lidhur me rehabilitimin fizioterapeutik, edhe pse nga ekspertiza është konstatuar se te paditësit ka qenë i nevojshme rehabilitimi fizioterapeutik, dha të te paditësit A.B dhe A.C - B, në kohëzgjatje prej 10 ditëve brenda vitit të parë të aksidentit, ndërsa te paditësi i mituri R.B, në kohëzgjatje prej 7 ditëve brenda vitit të parë të aksidentit. Sipas vlerësimit të gjykatës nga data e shkaktimit të aksidentit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor paditësi me asnjë provë nuk kanë vetëtuar gjykatë, që të njëjtëve në emër të trajtimit- rehabilitim fizioterapeutik, në vitin e parë pas aksidentit iu janë shkaktuar shpenzime në shuma siç pretendojnë paditësit, sipas kërkesëpadisë së precizuar. Andaj, gjykata se në rastin konkret në mungesë të provave kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e dëmit për rehabilitim fizioterapeutik, e ka refuzuar si të pa bazuar.

Gjykata ka analizuar edhe provat tjera dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me lartësinë e kamatës është marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u bazuar në dispozita të neneve 136, 140, 159 dhe 183 të LMD-së, dhe duke u mbështetur në dispozitat e neneve 143, 323, dhe 390 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata e morri duke u mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 450.2 të LPK-së në bazë të suksesit në kontest, si dhe përpilimin e parashtrësave dhe përfaqësimet në seancë sipas vlerës së kërkesëpadisë të aprovuar.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.556/2022, më datë 12.06.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.